

Paga ka, por s'ka punonjës!

RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2023



AUTOR

VALMIRA HOXHA

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Tabela e përmbajtjes:

1. Hyrje	3
2. Historiku i sektorit të turizmit në Shqipëri	3
3. Turizmi përballë sfidave	5
4. Punësimi, kriza e turizmit	7
5. Kostot Oportune të punësimit të shtetasve të huaj	11
6. Përfundime:	13
7. Rekomandime:	14
Bibliografia:	15

1. Hyrje

Një ndër sektorët e ekonomisë me kontributin më të madh në GDP dhe me rritje më të shpejtë viteve të fundit, është ai i turizmit. Sektori i turizmit gjatë vitit 2022 ka grumbulluar 2,840 milionë Euro të ardhura nga shtetasit e huaj. 48.5% më shumë në raport me vitin paraardhës¹. Një sektor i ekonomisë dikur i pashpresë, krahas strategjive të shunta të ndërmarra gjatë 10 vjeçarit të fundit ka njohur një zhvillim mjaft të shpejtë. Problematikat parësore që kyy sektor ka hasur kanë qenë ato me në qendër ndërhyrjet infrastrukturore. Ndërhyrjet në transport, komunikim, energji dhe akomodim ishin hapat e parë për mundësimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e turizmit në vend. Hov ka marrë turizmi bregdetar, i cili mban edhe kryesinë e të ardhurave më të larta sa i përket turizmit. Ka njohur zgjerim edhe si sektor më vete, dikur i përqendruar në Velipojë, Shëngjin, Durrës, Vlorë dhe Sarandë, tanimë turizmi bregdetar në Shqipëri është i fokusuar kryesisht në Velipoje, Tale, Gjiri Lalzit, Durrës, Golem, Vlorë Dhërmi, Himarë, Borsh, Sarandë.

2,717,762 vizitorë kanë qenë në strukturat akomoduese afër zonave bregdetare për vitin 2022, 13% më shumë se vitin e kaluar. Për të rritur numrin e vizitorëve është bërë e mundur edhe rritja e kapaciteteve për hapësira akomoduese, duke rritur numrin e lejeve të dhënave për ndërtimin e këtyre hapësirave.

Element shumë i rëndësishëm i turizmit, veçanërisht kur flasim për zgjerim të kësaj industrie është edhe fuqia punëtore. Fuqia punëtore është çelësi kyç i suksesit të një industrie në zhvillim, krahas strategjive largpamëse dhe instrumentave teknologjik. Gjate 3 vjeçarit të fundit, ky sektor po përballlet me mungesë të theksuar të fuqisë punëtore vendase. Sektori po përballlet me një shkallë qarkullimi të lartë dhe si rrugëzgjdhje për plotësimin e nevojave për shtim stafi po e shikon në punësimin e shtetasve të huaj. Kjo zgjidhje ka rritur ndjeshëm kostot për bizneset e përfshira në këtë industri por edhe shkallën e pasigurisë në kthimin e këtij investimi dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

2. Historiku i sektorit të turizmit në Shqipëri


Pasuritë natyrore, relievi, monumentet kulturore, historia, pozicioni gjeografik apo dhe klima janë vetëm disa nga elementët të cilët favorizojnë zhvillimin e industrisë së turizmit në Shqipëri. Që pas ndryshimit të sistemit politik, Shqipëria ka qenë një atraksion turistik. Vëmendja kryesore aso kohe ishte rrjedha historiko-politike e vendit, por turizmi akoma nuk kishte nisur të konsolidohej. Problemi kryesor qëndronte tek infrastruktura. Gjendja infrastrukturore e Shqipërisë ishte

¹ <https://turizmi.gov.al/statistikat-e-turizmit-2022/>

mjaft e dërrmuar, për këtë arsye investimet e para të huaja kishin në fokus këtë linjë. Nga viti 1992-2009 janë hartuar dhe zhvilluar 3 strategji sektoriale për turizmin në vend, por asnjëra prej tyre nuk rezultoi e efektshme. Shkak për këtë ishte gjendja e rënduar ekonomike që vendi kaloi.

Në vitet 2011-2012, kemi hapat e parë të zhvillimit të këtij sektori. Fokusi u vendos në shtimin e strukturave akomoduese dhe përmirësim të ndjeshëm të infrastrukturës si dy ndër problemet më madhore me turizmin. Gjatë kësaj periudhe u dha një numër i madh lelesh për ndërtim strukturash akomoduese, rregulluan akse rrugore pranë zonave turistike, aeroporti “Nënë Tereza”, porti i Durrësit etj. U dha një vëmendje më e madhe ndaj sigurimit me energji elektrike dhe ujë .

Efektet e këtyre politikave ekzistenciale për sigurimin e flukseve sadopak të turizmit nisën të reflektoheshin edhe në të ardhurat në buxhetin e shtetit dhe një rritje të ndjeshme të numrit të vizitorëve. Vitet më të mira për turizmin në vend ishte ai i 2019-ës dhe ai i 2022 për nga shifrat rekord të arritura në lidhje me numrin e vizitorëve dhe të ardhurat e gjeneruara. Turizmi nga 4% të GDP-së, tani zë rreth 17% të tij. Numri i strukturave akomoduese në 2013 ishte rreth 840, ndërkohë që në 2021 rezultonin rreth 2900 të tilla. Numër i cili ka pësuar rritje gjithashtu vitin e fundit.



Burimi: INSTAT

Nisur nga të dhënat e INSTAT arrijmë të identifikojmë trendin në rritje të numrit të vizitorëve, veçanërisht të huajve. Vlerat më të larta mbajnë 2019 me mbi 6 milion vizitorë të huaj dhe 2022 me mbi 7.5 milion vizitorë.

Element që vlen të trajtohet është edhe numri i vizitorëve vendas si një pjesë mjaft e rëndësishme e sektorit të turizmit gjithashtu. Vihet re se me rritjen në ritme të shpejta të numrit të vizitorëve, deri në 2019 flasim për rritje thuajse në ritme të barabarta në të dyja kategoritë. Sakaq, pas rimëkëmbjes së industrisë nga pandemia dhe kufizimet shoqëruese, numri i vizitorëve vendas për 2022, vit i cili shënoj edhe vlera rekord për turizmin është më i ulët së ai i vitit parapandemisë.

3. Turizmi përballë sfidave

Mjedisi operues për sektorin e turizmit në Shqipëri ka qenë gjithmonë mjaft sfidues, e hera-herës edhe i vështirë për tu manovruar. Krahas ecurisë mjaft pozitive që sektori i turizmit ka bërë, viteve të fundit po përballet edhe me sfida të shumta. Në varësi të llojit të turizmit identifikohen më lehtësisht sfidat shoqëruese të tij. Turizmi malor ka probleme me infrastrukturën, akset rrugore, ngritjen e më tepër strukturave akomoduese. Turizmi kulturor dhe historik, tërheqjen e numrit më të lartë të vizitorëve, rikonstruktimet e promovimet e ambjenteve dhe hapësirave si dhe formalizimi i tyre. Sa i përket turizmit bregdetar i cili përbën edhe pjesën më të madhe nga të cilat varen edhe të ardhurat që vijnë nga turizmi, vështirësi ka akoma me infrastrukurën, kushtet dhe cilësinë e ofruar. Nuk ka një shpërndarje të barabartë ose të përafërt të pushuesve gjatë vijës bregdetare, kemi të bëjmë më tepër me mbipopullim të zonave specifike dhe ne zona të tjera largim ose reduktim të numrit të pushuesve të përvitshëm.


3 nga problemet më madhore për turizmin bregdetar kryesisht por pasojat e së cilit po përhapen edhe në degët e tjera të turizmit janë:

1. Mungesa e planifikimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë.
2. Sezonalizimi i turizmit, veçanërisht atij bregdetar.
3. Mungesa e lartë për fuqi punëtore.

Kur flasim për **planifikim të qëndrueshëm** bëhet fjalë për një sarë elementësh trajtues. Në vendin tonë mungon një planifikim i mirëfilltë për sektorin e turizmit, i orientuar në të gjithë turizmin e jo vetëm atë bregdetar. E rëndësishme është vënia në fokus e elementëve që stimulojnë zhvillimin dhe qëndrueshmërinë në periudha afatgjatë dhe promovojnë një standard e cilësi të caktuar. Për të arritur në një planifikim të mirë dhe efektiv duhet bërë identifikimi i detajuar i nevojave dhe problematikave kryesore që shoqërojnë sektorin e turizmit dhe gjithë aktorët kryesorë të përfshirë në këtë industri. Vetëm në momentin që janë mirëidentifikuar nevojat mund të flitet për

ndërhyrje. Edhe në këtë hap është e rëndësishme diferencimi ndërmjet nevojave për ndërhyrje imediate dhe atyre me impakt strategjik. Shqipëria ka akoma probleme me ofrimin e kushteve bazë të një infrastrukture të pranueshme për tërheqjen e turistëve, veçanërisht në zona rurale apo malore. Gjithashtu ndonëse e vështirë për tu konceptuar në zona të caktuara flitet akoma për mungesë furnizimi me ujë apo probleme me energjinë elektrike.

Përqëndrimi i pjesës më të madhe të sektorit të turizmit në turizmin bregdetar ka anët pozitive dhe negative. Shqipëria krahas relievit mjaft të përshtatshëm për këtë lloj turizmit ka edhe një numër mjaft të lartë ditësh me diell, rreth 250-300 ditë me diell në qytete dhe zona bregdetare. Pavarësisht faktorëve mjaft favorizues, turizmi bregdetar në Shqipëri është tërësisht i sezonalizuar, kjo jo vetëm në zonat më rurale apo të veçuara por edhe në qytetet bregdetare. E gjithë kjo bën që pjesa më e madhe e ekonomisë së këtyre zonave të jetë e fokusuar vetëm gjatë intervalit kohor maj-shtator. Për një pjesë të bizneseve operuese në këto zona mund të jetë kthyer si proces rutinë, ku edhe klientela është e mësuar, nga ana e bizneseve të vogla ose të reja ka rreziqet e veta, mbajtja e kostove për 12 muaj me punën e 5 muajve të sezonin veror jo gjithmonë e justifikon qëndrimin në treg.



Burimi: INSTAT

Edhe lëvizjet, Hyrjet e vizitoreve të huaj dhe vendas gjatë tremujorëve arrijnë vlerat më të larta gjatë muajve korrik- gusht duke e mbështetur edhe më shumë argumentin e turizmit në Shqipëri si një turizëm sezonal.


2-3 vitet e fundit nga përfaqësuesit e sektorit të turizmit po llobohet që po ndeshen me një mungesë të lartë të fuqisë punëtore. Arsyet e kësaj mungese janë të shumta e ndërësaa pasojat vihen re në uljen e cilësisë së shërbimit, stafe të patrajnuar dhe pakualifikuar, tregje të lekundura dhe mungesë qëndrueshmërie.

4. Punësimi, kriza e turizmit

Viti 2020, i njohur ndryshe edhe si viti i Pandemisë, ndryshoi krejtësisht rrjedhën e tregut, por edhe mënyrën dhe qasjen e të bërit biznes. Kjo jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën. Për bizneset shqiptare, veçanërisht ato të sektorit të turizmit, situata me kufizimet ishte mjaft e vështirë për t'u përballuar. Një ndër vendimet më përgjithësues i cili është bërë gjatë asaj periudhe kohore ka qenë reduktimi i numrit të të punësuarve. Ky vendim ndonëse aspak i lehtë për t'u ndërmarr apo preferencial nga ana e drejtuesve të bizneseve, pati efekte negative në stabilitetin e sektorit, besnikërinë e punonjësve, plotësimin e kërkesës për punonjës që tregu ka pasur me heqjen e masave kufizuese.

Peshën më të madhe në të ardhurat nga turizmi në Shqipëri e zënë të ardhurat nga turizmi bregdetar duke u bazuar nga numri i netëqëndrimeve dhe shpenzimet e tjera të paketës së pushuesit.

Numri i netëve të qëndrimit nga vizitorë rezident sipas Struktura akomoduese dhe Viti.
Numri i netëve të qëndrimit nga vizitorë rezident.




Burimi: INSTAT

Në grafikun më lart pasqyrohet edhe një herë elementi i turizmit sezonal në Shqipëri. Përpos fokusimit të industrisë kryesisht në muajt korrik- gusht, vërehet që ngaa numri i netëqëndrimeve dhe numri i vizitorëve më i lartë shfaqet në strukturat akomoduese " Hotele dhe akomodime të ngjashme". Pasja e një vëmëndje të orientuar më tepër drejt këtyre elementeve sa i përket vizitorëve, bën që për palën

tjetër të drejtuesve të njësive ekonomike në këto zona apo që i përkasin strukturave të akomodimit, të kenë një mobilizim, investim dhe kërkesë më të lartë për punëtorë.


Pasja e një turizmi bregdetar sezonal i cili kryesisht ka një kohëzgjatje të aktiviteteve përgjatë majve qershor-shtator, shoqërohet me destabilitet të tregut dhe një mungesë qëndrueshmërie për fuqinë punëtore. Shkalla e qarkullimit të punonjësve është tepër e lartë veçanërisht në njësitë ekonomike të vogla. Në njësitë më të mëdha fuqia punëtore është më e stabilizuar ose besnike sa i përket çështjes së rikthimit, ama viteve të fundit ky problem sa vjen e bëhet më serioz. Për punëdhënësin momenti i rekrutimit të punëtorëve për sezonin veror në pikat turistike është bërë një sfidë më vete, shkak kryesor shkalla e lartë e qarkullimit.

Treguesit ekonomike sipas Aktiviteti ekonomik dhe Viti. Gjithsej, Të punësuar gjithsej, numri mesatar vjetor , Treguesit ekonomike.




Burimi: INSTAT

Paga mesatare mujore për një të punësuar sipas aktiviteteve ekonomike sipas Aktiviteti Ekonomik dhe Viti. Paga mesatare mujore për një të punësuar sipas aktiviteteve ekonomike.



Paga mesatare mujore bruto sipas Aktiviteti ekonomik dhe Viti. Paga mesatare mujore bruto.



Burimi: INSTAT

Grafikët më lart afishojnë të dhënat nga viti 2015-2021 sa i përket numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave apo shpenzimeve të personelit në tre sektorë që lidhen në mënyrë direkte dhe të tërthortë me industrinë e turizmit. është veçuar sektori i “Akomodimi dhe shërbimi ushqimor” si sektori i lidhur në mënyrë direkte me hotelerinë/turizmin; “Transporti, informacioni dhe komunikacioni” dhe “Shërbimet” si dy sektorë që lidhen më tërthorazi me turizmin. Numri i të punësuarve është përafërsisht 60 mijë punëtorë për “Akomodim dhe shërbim ushqimor”. Këto shifra paraqiteshin zyrtarisht nga INSTAT-i. Tre vite më vonë kemi të bëjmë me një zgjerim tregu dhe rrjedhimisht zgjerim të kërkesës për punëtorë gjithashtu. Problemi me këto shifra është se sa reale janë ato. Punësimi i padeklaruar ose “puna në të zezë”, ndonëse po luftohet vazhdon të jetë një fenomen mjaft i përhapur në Shqipëri, veçanërisht në periudha afatshkurtra si punësimet sezonale. Probabiliteti që numri i të punësuarve brenda këtij sektori është më i madh, është tepër i lartë.

Pjesa e pagave apo shpenzimeve për personelin është një element tjetër mjaft i rëndësishëm kur flasim për punësimin dhe turizmin. Në të dhënat e afishuara më lart flasim për fasho pagash brënda sektorit të “Akomodimit dhe shërbimit ushqimor” në vlera minimale ose fare prane pagës minimale funksionale për vitet e mëparshme. Pagat mesatare të deklaruara janë nën fashon 25 000- 45 000 Lekë Bruto.

Vlera mjaft të ulëta duke gjykuar të ardhurat në rritje në këtë sektor si dhe cilësimi nga përfaqësues të sektorit të turizmit dhe punonjësve gjithashtu për paga të kënaqshme. Nga ana e përfaqësuesve të njësive ekonomike² shpeshherë është mbrojtur argumenti që industria e turizmit nuk vuan ose nuk preket nga paga minimale dhe rritja e saj, sepse sektori ka vite që paguan mbi pagën minimale. Të dhënat e deklaruara tregojnë një situatë krejtësisht tjetër, por edhe shpërngulja e një numri të lartë të rinjve drejt zonave bregdetare mbron edhe me tëpër argumentin që përfaqësuesit e bizneseve të lidhura me turizmin japin mbi pagat.

Në bazë të disa vëzhgimeve të funksionimit të industrisë së turizmit sa i përket çështjeve të lidhura me punonjësit janë vënë re elementët e mëposhtëm.


- Punëtori tipik i përket grupmoshës 20-30 vjeç, kryesisht mbizotëron numri i meshkujve të punësuar krahas femrave. Përashfim bëhet tek punonjësit që merren me pastrimin ose me sigurinë, në këto profile pune intervali i moshës është më i gjerë.
- Pagat variojnë sipas pozicionit dhe profilit të punës. Kamariet i thjeshtë +50 000 Lekë Neto (+Bonuse); Kamariet i parë + 60 000 Lekë Neto (+ Bonuse); Banakier +70 000; Receptonist 50 000-70 000 Lekë Neto; Sanitarë 45 000-70 000 Lekë Neto. Kuzhina, Ndihmës kuzhinier i specializuar në profile të ndryshme 80 000-90 000 Lekë; Sallatier 60 000 Lekë; Ndihmës kuzhinier i thjeshtë 40 000-50 000 Lekë; Zv. Shef kuzhine 150 000 Lekë; Shefi kuzhinës 200 000- 300 000 Lekë.
- Një pjesë e mirë e punonjësve sezonal janë të pa deklaruar dhe të pa siguruar. (Nga vrojtime të mbi 50% stafit).

Në bazë të këtyre të dhënave, kemi një mospërputhje të madhe midis të dhënave të deklaruara nga organet kompetente, deklaratave të përfaqësuesve të sektorit dhe vrojtimeve të bëra kundrejt punonjësve. Përmbledhja e këtyre informacioneve detajon problemet me deklarimin e punonjësve dhe kontributeve gjë që na sjell pasjen e indikatorëve jo real në momentin e bërjes së analizave të tregut.

² <https://shqiptarja.com/lajm/krize-per-punetoret-topuzi-ne-report-tv-turizmi-ka-sfida-te-medha-duhet-ta-ktheime-ne-profesion-per-punonjesit>

5. Kostot Oportune të punësimit të shtetasve të huaj

Tregu i industrisë së turizmit po përballet me një krizë të theksuar për punonjës. Turizmi nuk është sektori i vetëm që po përballet me një krizë të tiller, por është një nga sektorët që impaktohet më tepër dhe efektet e kësaj krize reflektohen në mënyrë direkte në cilësinë e shërbimit, të ardhura më pak të grumbulluara, ndërkohë që turizmi zë rreth 17% të GDP-së. Arsyet e kësaj krize janë elaboluara edhe më lart, shkak kryesor mbetet sezonaliteti i lartë i këtij sektori, mungesa e qëndrueshmërisë dhe më pak aspekti i kushteve. Përfaqësuesit shprehën se bizneset nuk kanë mundësi ekonomike që t'i mbajnë punonjësit për 12 muaj ndërkohë që aktiviteti i këtyre bizneseve përkon 4-5 muaj. Mungesa e stabilitetit bën që shkalla e qarkullimit të jetë mesatarisht e lartë dhe të rinjtë mos ta skojnë sektorin e turizmit si një profesion premtues për të ardhmen por një punë sezonale nga ku mund të fitojnë më tepër të ardhura. Mospasja e të rinjve të kualifikuar si dhe rritja progresive e industrisë së turizmit ka bërë të domosdoshëm rritjen edhe të kërkesës për punonjës. Dëshpërimisht duket se 2 viteve të fundit, ky sektor po i drejtohet punësimit të shtetasve të huaj.



Burimi: INSTAT

Më lart është numri i lejeve të dhëna për punësim ndaj shtetasve të huaj. Pavarësisht të dhënave jo të përditësuar, numri më i lartë i lejeve rreth 7 500 daton në 2019, viti i cili shënoj bum-in e të ardhurave

dhe zhvillimit që pati turizmi. Shikojmë një rënie të numrit të lejeve ne 2020, shkak i situatës së mbylljes së kufinjve dhe rritjen e masave për udhëtime/punë. Tendenca parashikohet që ne vitin 2022 ka pësuar rritje dhe ndjeshme dhe ne 2023 pritet një valë e madhe fluksi të të huajve të cilët janë pajisur me leje qëndrimi pune dhe po bëhen gati të presin pushuesit në prag të nisjes së sezonit turistik për 2023. Vetëm për Durrësin, autoritetet e migracionit gjatë 3 muajve të parë të vitit kanë aprovuar 312 leje qëndrimi për motive pune, ndërkohë që po procesojnë me miratimin e kërkesave të tjera. Shtetasin e huaj kryesisht vijnë nga: Turqia, Maqedonia e Veriut apo Filipinet.

Për një biznes shqiptar, kostot e mbajtjes së një shtetasi variojnë nga 20-30% më shumë se sa të një punonjësi të zakonshëm vendas, ku peshojnë edhe shpenzimet për dokumentacionet. Pavarësisht kësaj duket se tanimë punësimi i shtetasve të huaj po bëhet e domosdoshme për sipërmarrësit e industrisë së turizmit si zgjidhja e vetme e mbetur përballë mungesës së punëtorëve në tregun vendas.

6. Përfundime:

- Industria e Turizmit në Shqipëri ka pësuar rritje të shpejtë dhe premtuese sa i përkon viteve të fundit. 2019 dhe 2022 shënojnë vlerat historike më të larta sa i përket numrit të vizitorëve dhe të ardhurave të arkëtuara në buxhetin e shtetit. Gjithashtu edhe pesha që ky sektor mban në Prodhimin e Brëndshëm Bruto është rritur në vlerë të konsiderueshme me kalimin e viteve nga 4 në 17%.
- Pavarësisht zhvillimit të shpejtë, turizmi në Shqipëri, është i përqendruar dhe pjesën më të madhe të të ardhurave e siguron nga turizmi bregdetar i cili është i shoqëruar me një sari problematikash. Kryeson sezonaliteti i lartë, shkalla e qarkullimit të punonjësve dhe mungesa e fuqisë punëtore, që rrezikojnë të ndikojnë në cilësinë e shërbimit dhe marrjen e vendimeve jo shumë favorizuese dhe të mirëmenduara për biznesin.
- Mungesa e fuqisë punëtore në turizmin bregdetar vjen si pasojë e mospasjes në fokus nga ana e të rinjve (si përqëndrimi më i madh i fuqisë punëtore) të profileve të turizmit si një profesion premtues për të ardhmen. Kjo problematikë sjell staf të pakualifikuar, probleme me trajnimin e tyre dhe investim të çuar dëm si pasojë e shkallës së qarkullimit. Biznesi shfaqet i pafuqishëm në mbajtjen e punonjësve edhe jashtë sezonit të aktivitetit turistik.
- Ekziston një mospërputhje ndërmjet të dhënave të publikuara nga institucionet përkatëse dhe situatës reale të numrit të të punësuarve, pagave dhe lejeve të qëndrimit reale me të cilët bizneset perojnë. Nga vëzhgimet dhe deklaratat nga përfaqësues të sektorit shfaqet një mospërputhje e këtyre elementëve në shift e publikuara.
- Mungesa e fuqisë punëtore ka drejtuar drejtuesit e bizneseve në punësimin e shtetasve të huaj, Ajo çfarë nisi si një frikë e drejtuesve të njësive ekonomike tanimë po kthehet në realitet gjatë 2 viteve të fundit. Për drejtuesit punësimi i shtetasve të huaj rrit 20-30% në koston për punëtorë, por ndikon gjithashtu pozitivisht në cilësinë e shërbimit dhe të punës. Problem ose shqetësim i vetëm ngelet qarkullimi i këtyre punonjësve ose përdorimi i vendit si “trampoline” për kalimin në vendet e Europës Qëndrore.

7. Rekomandime:

- Marrja e masave për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit dhe ndërhyrjeve infrastrukturore që ndikojnë në zhvillimin e turizmit veçanërisht në zona rurale po periferike.
- Hartimi i strategjive afatgjata mbi turizmin bregdetar që stimulojnë zhvillimin e këtij sektori edhe jashtë sezonalitetit të parashikuar. Stimulimi i një sezoni bregdetar më të zgjatur dhe suportimi nga ana e institucioneve për realizimin e këtij plani. Kjo do ndikojë në reduktimin e shkallës së ndikueshmërisë së problemeve kryesore me të cilat po përballlet turizmi bregdetar aktualisht.
- Vënia në fokus e kontrolleve periodike dhe të detajuara të industrisë së turizmit. Këto kontrolle duhet të kenë në vëmendje mospërputhjen midis numrit real të punonjësve, deklarimi i tyre pranë institucioneve përkatëse, deklarimi i pagave rele të këtyre punonjësve si dhe deklarimi i numrit real të lejeve të qëndrimit për motive pune që deklarohen nga drejtuesit e njësive të bizneseve të këtij sektori.

Bibliografia:

1. INSTAT,
http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_MM/MIM5/chart/chartViewColumn/.
2. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive,
<https://puna.gov.al/home>.
3. "Buletin Statistikor 2022." *Ministria e Turizmit*, <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Strukturat-Akomoduese-2022.pdf>.
4. "Krizë për punëtorët, Topuzi në Report Tv: Turizmi ka sfida të mëdha, duhet ta kthejmë në profesion për punonjësit." *Shqiptarja.com*, 28 March 2023, <https://shqiptarja.com/lajm/krize-per-punetoret-topuzi-ne-report-tv-turizmi-ka-sfida-te-medha-duhet-ta-kthejme-ne-profesion-per-punonjesit>.
5. "Lista e Operatoreve Turistik." *Ministria e Turizmit*, 6 January 2023, <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Lista-e-operatoreve-turistike.pdf>.
6. "Lista e strukturave akomoduese." *Ministria e Turizmit*, <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/Lista-e-strukturave-akomoduese-te-kategorizuara.pdf>.
7. "Ministria e Turizmit." *Turizmi.gov.al*, <https://turizmi.gov.al/>.
8. "Punëtorë të huaj në Durrës/ Kushtojnë më shumë, por japin shërbim më të mirë." *Top Channel*, 25 April 2023, <https://top-channel.tv/2023/04/25/punetore-te-huaj-ne-durres-kushtojne-me-shume-por-japin-sherbim-me-te-mire/>.
9. "Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike." *Instat*, <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-strukturore-t%C3%AB-nd%C3%ABmarrjeve-ekonomike/#tab2>.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al